



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:084661

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05744784

SCC-09-0032

Paditësi

Paditësit; H1, G, Sh, R1, H2, O, Sh, E, H3, R2 dhe B të gjithë nga fshati K e E, Komuna e Glllogocit, të cilin i përfaqëson avokati Rr H nga Glllogoci.

Kundër:

Të të paditurës;

NSH Drenica e cila administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga Dritan Hoxha nr.55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji në përbërje nga gjyqtari kryesues Asllan Krasniqi dhe gjyqtarët anëtarë; Sylejman Shumolli dhe Agron Hoxhaj, në seancën dëgjimore publike të mbajtur me datën; 28.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PËR SHKAK TË MOSPARAQITJES

Hedhet poshtë kërkesëpadia e paditësve; H1, G, Sh, R1, H2, O, Sh, E, H3, R2 dhe B të gjithë nga fshati K e E Komuna e Glllogocit, lidhur me pretendimet e tyre për vërtetimin e pronësisë për ngastrën kadastrale që shtrihen në vendin e quajtur Rr „B dhe M zona kadastrale K e E Komuna e Glllogocit me të cilën do të detyrohet NSH Drenica që tju njoh këtë të drejtë.

2. Nuk caktohen taksa gjyqësore.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Paditësit;H1,G,Sh,R1,H2, O,Sh,E,H3,R2 dhe B të gjithë nga fshati K e E ,Komuna e Glllogocit,me datën;11.03.2009 përmes të autorizuarit të tyre me shkrim avokatit Rr H nga Glllogoci kanë ushtruar padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me vërtetimin e pronësisë për ngastrat kadastrale që shtrihen në vendin e quajtur Rr,B dhe M zona kadastrale K e E Komuna e Glllogocit me të cilën do të detyrohet NSH Drenica që tui njoh këtë të drejtë.

Me datën;01.03.2024 Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme e Kosovës ka ftuar me ftesa të rregullta palët ndërgjyqëse për të prezantuar në seancën e datës;28.05.2024 dhe ka vlerësuar se sipas shënimeve të cilat gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet se të njëjtit i kanë pranuar ftesat me kohë dhe të pranuar në mënyrë të rregullt.

I autorizuarit i palës së paditur në seancën e mbajtur me datën;28.05.2024 pas njohtimit nga gjykata e pala paditëse nuk prezanton në këtë seancë edhe pse ftesën e ka pranuar në mënyrë të rregullt dhe me kohë,mirëpo i njëjti nuk është paraqitur në këtë seancë dhe mosardhjen e tij nuk e ka arsytuar,i ka propozuar gjykatës që të merr Aktgjykim për shkak të mosparaqitjes konform nenit 58 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr.06/L-086.

Gjykata ka aprovuar propozimin e palës së paditur bazuar në dispozitën e nenit 58 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.06/L-086 duke vendosur ashtu si është përcaktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës;

Në bazë të nenit 62 paragrafi 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës,secila palë do ti heqë shpenzimet e veta.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet kërkesë me shkrim në afatin kohor prej 30 ditëve për prishjen e këtij aktgjykimi Gjykatës së shkallës së parë e cila e ka marrë këtë aktgjykim,ndërsa nëse kjo gjykatë e refuzon kërkesën e palës paditëse me aktvendim,atëherë i njëjti mund ti drejtohet me ankesë Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës,brenda afatit prej 15 ditësh,llogaritur nga data e pranimit të këtij aktvendimi.

Asllan Krasniqi, Gjyqtar kryesues

Sylejman Shumolli, Gjyqtar

Agron Hoxhaj,Gjyqtar